



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 247/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren, paraqitur kundër Bashkimi Demokratik (BD), në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në objektin publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prizren, kështu që Bashkimi Demokratik (BD), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 450 (katërqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 11.10.2013, nga LDK, me të cilën pretendohet se anëtarë të subjektit politik BK, në Prizren kanë vendosur Me datën 11.10.2013, subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, subjekti politik Bashkimi Demokratik ka vendosur flamuj në shtyllat e ndriçimit në Prizren, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e nenit 33 pika b e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi subjektin politik BD në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr. 247/2, PZAP-mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik BD, në të cilën ka sqaruar se është e vërtetë se flamujt e tyre gjenden në shtylla elektrike, mirëpo duke u nisur nga ajo se në këtë kohë nuk ka ndonjë festë, ata janë të vendosur në vendin e dedikuar dhe se këto shtylla gjenden afër zyrës se tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se flamujt e BD-së janë të vendosur në rrugën publike, e që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike, në apo mbi rrugët publike, ne shenjat publike te trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.
- Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës , të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se flamujt e BD-së, janë të vendosur në rrugën publike të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se, Bashkimi Demokratik merr pjesë për herë të parë si subjekt politik për Zgjedhjet Lokale dhe se ky subjekt politik merr pjesë në gara për kryetar komune vetëm në Komunën e Prizrenit .

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik BD është shkelur neni 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se flamujt e subjektit politik BD janë vendosur në rrugën publike, si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, marrjen pjesë për herë të parë në Zgjedhje Lokale, Rregulla nr. 1 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave në kuptim të

nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 247/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*